



## DREJTORIA E INSPEKTIMIT FINANCIAR PUBLIK

### DENONCONI KORRUPSIONIN ME FONDET PUBLIKE

Në zbatim të ligjit nr. 112/2015 “Për inspektimin financiar publik”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është autoriteti përgjegjës për funksionimin e inspektimit financiar publik, në mbrojtje të interesave financiarë të njësive publike, kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë inkurajon çdo subjekt publik dhe punonjës/person anonim, që të denoncojë korrupsionin me fondet publike, me qëllim ndëshkimin e praktikave korruptive dhe vënien përpara përgjegjësisë të shkelësve të ligjit, me synim garantimin e zbatimit të ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike dhe dhënien e ndihmës në përmirësimin e menaxhimit financiar publik.

*“Fonde publike” janë të gjitha fondet, përfshirë fondet e Bashkimit Europian dhe të donatorëve të tjerë, të cilat mblidhen, arkëtohen, mbahen, shpërndahen dhe shpenzohen nga njësitë publike dhe që përbëhen nga të ardhurat, shpenzimet, kreditë dhe grantet për njësitë publike”.*

Inspektimi financiar publik është veprimtari që kryhet pas faktit, për rregullshmërinë e transaksioneve dhe veprimtarive të tjera të menaxhimit financiar publik, të kryera nën përgjegjësinë e njësive publike dhe individëve.

**Inspektimi financiar publik nis vetëm mbi bazën e kërkesës, informacionit apo ankesës, burimet e të cilave janë:**

- Kërkesa nga titullarë të institucioneve qendrore e vendore, nga nëpunës autorizues të njësive publike, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga Prokurori i Përgjithshëm, nga OLAF-i.
- Informacione për parregullsi nga auditimi i brendshëm ose nga menaxhimi financiar dhe kontrolli.
- Ankesa nga punonjës në sektorin publik apo privat, nga çdo person fizik/juridik, nga persona anonimë.

**Procedura dhe vendimmarrja për fillimin e inspektimit financiar publik bazohet në kërkesat, informacionet apo ankesat, të cilat duhet të plotësojnë këto kushte:**

- “Kërkesa” duhet të jetë hartuar zyrtarisht, të jetë specifike dhe të referojë në ngjarje dhe mundësisht në persona konkretë. Në të duhet të identifikohet qartë fakti/faktet që ngre/ngrenë dyshimin për ekzistencën e elementëve të keqmenaxhimit të rëndë financiar, vjedhjes, mashtrimit, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit.
- “Informacioni” duhet të jetë hartuar zyrtarisht, t’i referohet ngjarjes që mund të jetë objekt inspektimi financiar publik.
- “Ankesa” duhet të përmbajë dyshime të arsyeshme për ekzistencën e parregullsive. Edhe në rastin kur hartuesi i ankesës nuk konfirmohet, trajtimi i saj kryhet si të gjitha dokumentet e tjera që shërbejnë për fillimin e inspektimit financiar publik.

- Kërkesat, informacionet dhe ankesat për inspektim financiar publik, duhet të dorëzohen në protokollin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet rrugës postare ose dorazi, në adresën “Bulevardi Dëshmorët e Kombit”, nr.3, Tiranë.